



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.08, datë 24.11.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:

“LINJA 400 KV SHQIPËRI - MAQEDONI E VERIUT”,


ME VENDNDODHJE NË BASHKITË FIER, PATOS, ROSKOVEC, DIMAL,

KUÇOVË, BELSH, CËRRIK, ELBASAN, LIBRAZHD, PRRENJAS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturaës: “Linja 400 kv Shqipëri - Maqedoni e Veriut” me vendndodhje në Bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Dimal, Kuçovë, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Prrrenjas, me subjekt zhvillues shoqërinë “Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Fier, Patos, Roskovec, Dimal, Kuçovë, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Prrrenjas.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturaës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

